



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



Raport i Diskutimit Publik për Draft Planin Rregullues të Hollësishëm të Zonës Industriale

Komuna e Podujevës ka marrë vendim për iniciimin e procedurave të hartimit të Planit Rregullues të Hollësishëm të Zonës Industriale, me 28 dhjetor 2023.

Grupi i Operatorëve Ekonomik FST Engineering SH.P.K.; AL Engineering SH.P.K.; Enggroup SH.P.K., Prishtinë së bashku me grupin menaxhues së Komunës së Podujevës ka përgatitur Draftin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale. Ky dokument paraqet zhvillimin e qëndrueshëm për Komunën e Podujevës. Kjo zonë industriale e planifikuar mirë do të siguroj hapësira të mjaftueshme për operime në kushte optimale duke qenë bazë e informatave, rregullave dhe kushteve për rregullimin e lagjes.

Ky Draft Plan Rregullues i Hollësishëm për Zonën Industriale synon të kontriboj në nxitjen dhe inkurajimin e investimeve në Republikën e Kosovës, zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, hapjen e vendeve të reja të punës, aftësim profesional, përqëndrimin e bizneseve në një vend të caktuar, zgjerimin e bashkëpunimit mes bizneseve, furnizimin me ujë, energji dhe shërbime në mbështetje të bizneseve, si dhe nxitjen e rritjes së konkurrencës në bizneset vendore.

Draft Plani Rregullues i Hollësishëm për Zonën Industriale është përgatitur dhe proceduar në Kuvend më datë 04 mars 2024, hapja zyrtare e shqyrtimit publik është mbajtur me dt: 22.03.2024 në ora 15:18-15:48 (është mbajtur proces verbal), konsultimi fillestar publik është mbajtur me dt: 26.03.2024 në ora 10:30-11:15(është mbajtur proces verbal).

Në takimin e datës 22.03.2024 në bashkëbisedim ndërmjet drejtorit dhe qytetarëve u parashtruan pyetjet si: Sa hyrje do të ketë Zona Industriale dhe si do të planifikohet sipërfaqja për industrinë e lehtë? Drejtori u përgjigj se do të ketë tri hyrje momentale, ndërsa znj. Valesa Jahmurati tha se për industrinë e lehtë janë planifikuar sipërfaqet me përmasa 2500m²-10.000m². Nga ky takim nuk kishte propozime për t'u përfshirë në këtë draft projekt, por u parashtruan vetëm pyetje informuese.

Në takimin e datës 26.03.2024, u diskutua vetëm çështja e shpronësimit të pronave, gjë që nuk ishte tema për të cilën ishte thirrur takimi me qytetarë. Po ashtu edhe në këtë takim nuk kishte propozime me përmbajtje për t'u përfshirë në plan.

Shqyrtimi publik i Projekt Dokumentit ka zgjatë 30 ditë përkatësisht prej datës 22 mars 2024, deri më datë 22 prill 2024, sipas procedurave të përcaktuara me ligj. Brenda kësaj periudhe kohore propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet, kanë pasur mundësinë që të paraqiten me shkrim në

librin e vërejtjeve, si dhe në formë elektronike në e-mail adresat; blerina.zeka@rks-gov.net dhe info.podujeva@rk-gov.net.

Mirëpo, edhe pse janë bërë njoftimet për t'i paraqitur propozimet, vërejtjet apo sqarimet, përgjatë periudhës së shqyrtimi publik të Projekt Dokumentit nuk është pranuar asnjë vërejtje, sugjerim apo propozim qoftë në formë fizike apo edhe në atë elektronike.

Bashkëngjitur në këtë raport gjeni:

1. Vendimin për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale në Komunën e Podujevës
 - <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2023/12/Thirrja-e-mbl.-Kuv.-28.12.2023.pdf>
2. Vendimi për vënie në shqyrtim publik të Projekt Dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale në Komunën e Podujevës
 - <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2024/04/1.Vendim-per-Shqyrtim-Publik-PRRH-per-Zonen-Industriale.pdf>
3. Njoftimit për diskutim publik:
 - <https://kk.rks-gov.net/podujeve/?newscpt=njoftim-vendim-per-venie-ne-shqyrtim-publik-te-projekt-dokumentit-te-planit-rregullues-te-hollesishem-per-zonen-industriale-ne-komunen-e-podujeves>
 - <https://www.facebook.com/KomunaEPodujeves/posts/pfbid03pbVqayv7o3pLV1TPY76qLk5CdWjNYUmDG26g1QcQ2Ad1Xz7S2NT4q4pYksFvi2l>
4. Materiali i draft Planit Rregullues të Hollësishëm Të Zonës Industriale:
 - https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2024/03/Pjesa-Tekstuale_Pershkrimi-teknik-dhe-paramasa.pdf
 - https://kk.rks-gov.net/podujeve/?page_id=200043017
5. Procesverbalin e hapjes zyrtare të shqyrtimit publik dhe listën e pjesëmarrësve të datës 22.03.2024;
6. Procesverbalin e konsultimit fillestar publik dhe fotografitë e pjesëmarrësve të datës 26.03.2024;

Podujevë, datë 26.04.2024

Raportin e përgatiti

Blerina Zeka

